



REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DOKUMENTAT STANDARDE

PROCEDURË E PËRSHPEJTUAR - RINDËRTIMI SHËRBIME¹

"Mbikëqyrja e punimeve për "Rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar."

¹

Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash Autoriteti Përgjegjës do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

I NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Përgjegjës

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë
Tel/Fax +355 4 234885
Adresa email: prokurimet@albaniandf.org
Faqja e Internetit: www.albaniandf.org

1.2 Lloji i autoritetit përgjegjës:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësi e qeverisjes vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	X

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-68773-08-14-2020

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”

Konkurs Projektimi Shërbime Konsulencë Shërbime të tjera

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po Jo

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë **Po X**

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara **Po** **Jo X**

Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një apo më shumë autoriteteve përgjegjës dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: pa përcaktim.

2.6	<p>Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike</p>	<p>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje.</p> <p>Kontratat do të lidhen sipas kerkesave të Autoriteteve përgjegjës të përcaktuara në pikën 4.2 të DST-ve, me operatorin ekonomik të suksesshëm.</p> <p>Ne rast te lindjes se nevojes per te lidhur një kontrate brenda marrëveshjes kuader, autoriteti përgjegjes duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek operatorët, duke specifikuar listën me numrin e shtëpive dhe vendodhjen e tyre.</p> <p>Komunikimi ndërmjet autoritetit përgjegjes dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures.</p> <p>Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të kerkonte më pak apo më shumë supervision per pallatet se sa ato te parashikuara, (por ne çdo rast brenda vleres se perllogaritur te marreveshjes kuader).</p>
------------	---	--

2.7 Autoriteti përgjegjës / Autoritetet përgjegjëse, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit / vlera e përafert e marrëveshjes kuadër: 150,987,587 lekë pa tvsh. Buxheti i vënë në dispozicion për vitin 2020 është 30,197,517 leke pa TVSH sipas VKM Nr 587 Dt 22/07/2020. "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar."
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi _____**

Burimi i Financimit: Fondi i Rindërtimit ne Buxhetin e Shtetit.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër, "Mbikëqyrja e punimeve për "Rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar" në zonat: Durrës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë, Valias dhe Mirdite.

Objekti i marrëveshjes kuadër konsiston ne mbikëqyrjen e punimeve të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar. Zonat e detyruara te shpalluara per zhvillim ku FSHZH eshte njesi zbatuese jane: Durrës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë, Valias dhe Mirdite.

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës së zbatimit ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja e kontratës/kontratave në kuadër të kësaj marrëveshje kuadër do të jetë deri në **12 muaj** nga momenti i lidhjes ose me afat me të shkurtër në varësi të veçantisë së objektit të njësive të banimit.

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 24 muaj ose ditë: □□□□ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Ose duke filluar nga □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)

Shënim: Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër mund të jetë deri në 4 vjet.

2. Në raste të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër mund të zgjatet por pa teikaluar afatin maksimal 4 vjet.

3. Palët në marrëveshje kuadër mund të jenë dakord për zgjatjen e afati në rastin e forcës madhore dhe në rrithana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë

2.9 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:

Objektet arsimore te percaktuar ne lotet perkatese, bashkite, Durrës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë, Valias dhe Mirdite.

2.11 Ndarja në Lote:

Po Jo

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

Objekti dhe fondi limit i loteve)

1_____

2_____

etj

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per më tepër se një Lot ne rastet kur kerkohet, duhet të kenë kapacitetet financiare dhe teknike sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, te marra se bashku.

2.13 Opcionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (*nëse ka*):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo

Në asnjë rast nenkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.

Autoriteti përgjegjës do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo x

Shenime te tjera:

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:

Po □ Jo x

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po □ Jo x

Sekzioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës 13

3.2 Sigurimi i Ofertës: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 5. Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerë së përafërt të kontratës.

Sekzioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po □ Jo x

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuase të procedurës së anulluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar _____
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar _____
- c) Fondi i procedurës së prokurimit të anulluar _____

Kjo procedurë përfshin dy fazë kryesore:

Faza 1 – Kualifikimi / marreveshja kuadër:

Kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin per paraqitjen e ofertës financiare dhe dokumentat e kërkua në DT. Autoriteti Përgjegjës, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim. Autoriteti përgjegjës, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin edhe një cmim/ofertë referues/e, e cila gjatë fazës së dytë nuk duhet të jetë më e lartë.

Çmim/ofertë referues/e për fazën e parë:

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input checked="" type="checkbox"/> X
----	--------------------------	----	---------------------------------------

Faza 2 – Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës: Autoriteti Përgjegjës dërgon një ftesë për të dorëzuar ofertën, kandidatëve që janë kualifikuar palë në marrëveshjen kuadër, në Fazën 1.

Ofertat shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti Përgjegjës. Ky i fundit ia jep konratën atij Ofertuesi që ka paraqitur ofertën më të mirë të vlerësuar.

Oferta duhet të hartohet në përputhje me nenin 7 pika 1 te VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit” dhe do të shprehet në vlerë dhe në përqindje ulje nga fondi limit/vlera e parashikuar.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë:

(i) Cmimi më i ulët [0- 60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Cilësia [0 - 30]

Treguesit dhe analizë cilësore në punë duke përkatuar elementet e saj.

Autoriteti Përgjegjës duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur

(iii) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit [0 - 10]

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot në plan pune konkret, me qëllim për të realizuar shëbimet sipas afatit.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/08/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**.

Vendi: www.app.gov.al.

Kur kërkesa për shprehje interesit kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

4.4 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/08/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**.

Vendi: www.app.gov.al.

Informacioni që merret gjatë hapjes publike të kërkesave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kerkesa, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (e shprehur në ditë)

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit:

Shqip	<input checked="" type="checkbox"/>	Anglisht	<input type="checkbox"/>
Tjetër	<hr/>		

Seksioni 5

Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po Jo

Nëse Po

Monedha

 Çmimi

Ky çmim mbalon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **14/08/2020.**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë
Tel/Fax +355 4 234885
Adresa email: prokurimet@albaniandf.org
Faqja e Internetit: www.albaniandf.org

2. Lloji i procedurës se prokurimit: Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit).

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Mbikëqyrja e punimeve për “Rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar” në zonat: Durrës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë, Valias dhe Mirdite.

4. Numri i referencës së procedurës/lotit:**** REF-68773-08-14-2020

5. Fondi/kostoja e pritshme e kontratës: 150,987,587 lekë pa tvsh. Buxheti i vënë në dispozicion për vitin 2020 është 30,197,517 lekë pa TVSH sipas VKM Nr 587 Dt 22/07/2020. "Për Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kudër do të jetë 24 muaj. Kohëzgjatja e kontratës/kontratave do të jetë 12 muaj nga momenti i lidhjes ose me afat me të shkurtër në varësi të veçantisë së objektit.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 27.08.2020, ora 12:00.
www.app.gov.al.

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 27.08.2020, ora 12:00.
www.app.gov.al.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i kërkesës/ofertës

- 1.1 Kandidatët/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesën/ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Kërkesat/Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Kandidatët/Ofertuesit përballojne kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Përgjegjës nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë qe nuk fshihet. Të gjitha fletët e kerkesës/ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kerkeses/ofertës, përvèç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.
- 1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërmë (a) të LPP-së.

Seksioni 2 Faza 1 – Kualifikimi / marreveshja kuadër:

- 2.1 Paraqitja e kërkesave për duhet të bëhet brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Njoftimin e Kontratës. Kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin per paraqitjen e ofertës financiare dhe dokumentat e kërkua të DT. Autoriteti Përgjegjës, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim.
- 2.2. Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i kthehen Kandidatit të pahapura.

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të kërkesave që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesat e tyre.

- 2.3 Kërkesat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Kur Kërkesa kërcohët të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ate në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

- 2.3 Për procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Kandidatit dhe të shënuar: "Kërkesë për parakualifikimin në procedurën Nr. e Njoftimit të Kontratës _____

"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS. DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv), _____ orë".

Kur Kërkesa kërcohët të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Sekzioni 3 Faza 2 – Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës: Autoriteti Përgjegjës dërgon një ftesë për të dorëzuar ofertën, kandidatëve që janë kualifikuar palë në marrëveshjen kuadër, në Fazën 1.

- 3.1 Ofertat do të dorëzohen vetëm nga kandidatët që kanë marrë një ftesë për ofertë nga Autoriteti Përgjegjës, sipas modelit të dhënë në Shtojcën 2.

3.2 Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

- a) Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 3.
- b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 4.
- c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, etj*)

_____,
_____,
_____.

- d) (opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës "Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëni e Punës,, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo

punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërsësi.

- 3.3 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.
- 3.4 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën originale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për kryerjen e _____ shërbimeve; Nr e Njoftimit _____
“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv) orës ____”.

Kur oferta kërcohët të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Kur oferta kërcohët të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

- 3.5 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Përgjegjës me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: “**MODIFIKIM OFERTE**” ose “**TËRHEQJE OFERTE**”.

Kur oferta kërcohët të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpëra përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin përgjegjës, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 4 Përllogaritja e ofertës ekonomike

- 1.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të ekzekutohen dhe çmimin e tyre.
- 1.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

- 1.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 1.4 Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.
- 1.5 Sigurimi i Ofertës, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 1.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
 - a) garanci bankare
 - b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet bashkë me oferten para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Përgjegjës ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

4.7 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëminë e ofertave, autoriteti përgjegjës mund t'i kérkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Përgjegjës me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Përgjegjës lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kerkohet, atëherë Autoriteti Përgjegjës do të refuzojë ofertënn.

4.9 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Sekzioni 5. Vlerësimi i Ofertave

Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - jane pikët totale të ofertes së vlerësuar

$Pk1/Pk2/Pk3/\dots$ - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min}k1 \times P_{max}k1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{min}k1$ _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{max}k1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit. [0 - 10]

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.

Shënim: Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përparrë se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.

(ii) Çmimi më i ulët [0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(iii) Cilësia [0 - 30]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shmebull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjeter siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsiioneve. Plotësimi i të dy opsiioneve e bën procedurën të pavlefshme.

5.6 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

- 5.6.1 Autoriteti Përgjegjës korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Përgjegjës e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.
- 5.6.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Përgjegjës, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;
- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

5.7 Ofertat anomalisht të ulëta

- 5.7.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me shërbimet e ofruara, atëherë Autoriteti Përgjegjës i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Përgjegjës, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

- 5.7.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët:

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit / vlerës së përafërt të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP dhe

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

- O – Oferta
- Mo – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
- n – Numri i Ofertave të vlefshme
- Z_M – Zbritja e Mundshme

$$Mo = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% Mo$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM..... , si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

5.8 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 42 të Aktit Normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësise natyrore”.

Seksioni 6. Nënshkrimi i kontratës

6.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Përgjegjës njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 19. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

6.2 Sigurimi i kontratës

6.2.1 Autoriteti Përgjegjës kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 15 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 23 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

6.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
i. garanci bankare
ii. garanci sigurimi

6.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti përgjegjës dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Shënim: Autoritetet përgjegjëse nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pikë 1 në pikën 6.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

- Shtoja 1: Kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.
Shtoja 2: Formulari i Ftesës për Ofertë në rastin e marrëveshjes kuadër.
Shtoja 3: Formulari i Ofertës Ekonomike.
Shtoja 4: Deklaratë për paraqitje ofertë të pavarur.
Shtoja 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës.
Shtoja 6: Lista e Informacionit Konfidencial.
Shtoja 7: Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
Shtoja 8: Deklaratë mbi përbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik.
Shtoja 9: Deklaratë mbi përbushjen e kritereve të përgjithshme për kualifikim
Shtoja 10: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.
Shtoja 11: Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industrial.
Shtoja 12: Deklaratë mbi kontratat e lidhura ose në proces në kuadër të rindërtimit.
Shtoja 13: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër.
Shtoja 14: Formular për Kriteret e përgjithshme / të veçanta të Kualifikimit / pjesëmarrjes.
Shtoja 15: Specifikimet teknike.
Shtoja 16: Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit.
Shtoja 17: Termat e referencës.
Shtoja 18: Formular i Njoftimit të skualifikimit.
Shtoja 19: Formulari i Njoftimit të Fituesit.
Shtoja 20: Formulari i Njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër.
Shtoja 21: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
Shtoja 22: Kushtet e Veçanta të Kontratës.
Shtoja 23: Formulari i Sigurimit të Kontratës.
Shtoja 24: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar.
Shtoja 25: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.
Shtoja 26: Formulari i njoftimit të anulimit të procedurës.
Shtoja 27: Formulari i Ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik.
Shtoja 28: Draft Marrëveshja Kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.
Shtoja 29: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Shtojca 1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURË

(*Emri i operatorit ekonomik*)

[*Data _____*]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës*]

Procedura e prokurimit: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje në këtë procedurë:

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Përgjegjës)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

.....

.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).

Vendi i kryerjes së shërbimit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Kohëzgjatja e shërbimit _____

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën përfundimtare]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim _____

Elektronik (email, fax etj.) _____

Shtojca 3

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës*]

* * *

Procedura e prokurimit: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.					
2.					
3.					
Shuma					
TVSH					
SHUMA TOTAL					

Nënshkrimi i ofertuesit _____
Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 4

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Përgjegjës: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjeter ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Përgjegjës;
- b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
□
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
□
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 5

[*Letér me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë pér t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti përgjegjës*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës*]

Në emer të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/Nr.references ne faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit përgjegjës*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti përgjegjës e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpala nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesit publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës_____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në ninin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e

kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksimonit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkyetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es**.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

